

THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME

- Kontributi në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) -

Historiku

Kosova nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizimi Asociimit (MSA) me Bashkimin Europian (BE) në vjeshtën e vitit 2015 dhe marrëveshja hyri në fuqi në prill të vitit 2016. Kjo është marrëveshja e parë kontraktuale me BE-në dhe përbën bazën e përpjekjeve kyçe të reformës drejt një Kosove më demokratike, stabile dhe ekonomikisht më të suksesshme.

MSA-ja ka ndikim në të gjitha sferat e qeverisjes në Kosovë, ndërsa dy fushat më të rëndësishme të saj janë sundimi i ligjit dhe qeverisja ekonomike, përkatësisht konkurrenca. Përderisa Kosova orientohet drejt një tregu plotësisht të liberalizuar me BE-në, konkurrenca nga ana e kompanive europiane do të paraqet një sfidë për bizneset Kosovare, posaçërisht për prodhuesit, të cilët duhet të jenë të informuar në mënyrë adekuate, me kohë dhe të forcohen më tepër për t'u përballur me presionin e konkurrencës që vjen nga BE. Si rrjedhojë e kësaj, deficitit tregtar do të rritet dhe do të paraqes një sfidë për institucionet e Kosovës. Në përgjithësi, sektori i biznesit ka rol thelbësor brenda fushave të MSA-së dhe duhet të angazhohet në proces për të ndihmuar trajtimin e këtyre sfidave.

Në mars të vitit 2016, Qeveria e Kosovës miratoi Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) që është një listë prej afro 1,600 masash afatshkurta dhe afatmesme për t'u zbatuar deri në vitin 2021. Sipas vlerësimit të vetë Qeverisë, zbatimi i PKZMSA është sfidues dhe kërkon përpjekjet e të gjitha institucioneve publike dhe jopublike.

Përveç kësaj, në nëntor të vitit 2016, Komisioni Europian filloi dialogun e nivelit të lartë Kosovë-BE për prioritetet kryesore ose Agjendën e Reformave Europiane (ERA). Plani i veprimit të ERA ka marr mbështetjen e Kuvendit dhe paraqet prioritet të lartë për qeverinë aktuale. Dokumenti nxjerr në pah prioritetet kyçe në procesin e zbatimit të MSA-së. ERA përbëhet prej tri shtyllave: 1) Qeverisjes së Mirë dhe Sundimit të Ligjit, 2) Konkurrencës dhe Klimës së Investimeve; dhe 3) Arsimit dhe Punësimit. Nëse zbatohet në mënyrë efektive, ERA ka potencialin për të ndryshuar dinamikat e politikëbërjes në institucione dhe të japë përfitimet e para të marrëveshjes së MSA-së për qytetarët e Kosovës.

Zbatimi i MSA-së është një proces reformues gjithëpërfshirës që institucionet dhe shoqëria kosovare duhet të ndërmarrin. Procesi i reformës të BE-së do të përfitonte nga një përfshirje e shoqërisë civile, qoftë përmes rritjes së kërkesës për qeverisje të mirë, hulumtimit dhe analizës, ngritjes së kapaciteteve ose komunikimit më të mirë. Shoqatat e biznesit janë vetëm disa prej shumë akterëve të shoqërisë civile që luajnë një rol vendimtar në zbatimin e MSA-së. Ato mund të mobilizojnë anëtarët dhe t'i adresojnë shqetësimet e tyre drejt institucioneve të duhura. OShC-të tjera gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e reformës së BE-së, të tilla si grupet e ekspertëve, grupet e avokimit, qendrat për trajnim etj.

Përkrahur nga:



Në këtë aspekt, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile i bënë thirrje të gjitha organizatave të shoqërisë civile që të aplikojnë me projekt-propozime për të kontribuar në trajtimin e këtyre sfidave.

Objektivat

Granti nga Sida është një përkrahje shumëvjeçare për Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), i financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), me qëllim të mbështetjes së KCSF-së në realizimin e misionit dhe strategjisë së saj. Që nga themelimi i saj, KCSF ka qenë akter kryesor në forcimin dhe financimin e sektorit të shoqërisë civile në Kosovë. KCSF angazhohet në avancimin e mjedisit të punës për shoqërinë civile në Kosovë e më gjerë, ofron kontribut të drejtpërdrejt në proceset e politikëbërjes, promovon mundësitë ligjore dhe praktike për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në politikëbërje dhe në Agjendën Europiane të Kosovës, siguron mbështetje në ngritjen e kapaciteteve për OShC-të dhe akterët tjerë dhe bën rigrantimin e fondeve të donatorëve kyç të shoqërisë civile që veprojnë në Kosovë. Puna e KCSF-së bazohet në dy parime: 1) një shoqëri civile e guximshme dhe efektive është e domosdoshme për përparimin dhe mbështetjen e tranzicionit demokratik të Kosovës, dhe 2) perspektiva e integritit europian është nxitësi më i fuqishëm i reformave vendore në Kosovë. Përmes programit të Integritit Europian, KCSF është e përqendruar në rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e integritit europian dhe avancimin e agjendës Europiane të Kosovës.

Përderisa një pjesë e madhe e kësaj përkrahje shërben për të mbështetur aktivitetet e ndërmarra drejtpërdrejtë nga programet e saj, KCSF-ja synon të zgjerojë numrin e akterëve të përfshirë dhe të mbështesë projekte specifike të OShC-ve tjera në realizimin e strategjive të tyre programore. Në përkushtimin e saj drejt mbështetjes së agjendës Europiane të Kosovës, KCSF beson që përmes përkrahjes së partnerëve të shoqërisë civile do të kontribuojë drejtpërdrejtë në përforcimin e rolit të sektorit civil dhe do të shfrytëzojë potencialin për të dhënë kontributin ndaj zbatimit të MSA-së. Përveç kësaj, synohet të mobilizohet potenciali qytetar dhe të kontribuohet në agjendën Europiane duke shfrytëzuar vlerën shtesë që sjellin OShC-të partnere dhe duke përfituar nga sinergjia dhe komplementariteti me veprimet e KCSF-së.

Me qëllim të mbështetjes së organizatave partnere për t'u angazhuar në objektivin e KCSF-së, për të rritur pjesëmarrjen dhe kontributin e akterëve jo-shtetëror në agjendën Europiane, në kuadër të kësaj thirrjeje grantet kanë për qëllim që të mbështesin angazhimin e organizatave të shoqërisë civile në zbatimin e prioritetëve afatshkurta të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe masave të rradhitura në Agjendën e Reformave Europiane (ERA).

Masat e mbështetura në kuadër të kësaj ndërhyrjeje

Projekt-propozimet e dorëzuara për këtë thirrje duhet të konkretizohen në këto fusha:

- Lëvizja e lirë e mallrave
- Të drejtat e pronësisë intelektuale
- Konkurrenca

Përkrahur nga:



- Mbrojtja e konsumatorit
- Migracioni legal
- Promovimi i investimeve
- Turizmi
- Bujqësia
- Arsimi dhe trajnimi
- Bashkëpunimi kulturor
- Bashkëpunimi në fushën audio-vizuele, Rrjetet dhe Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit dhe Komunikimeve Elektronike

Ju lutemi që të keni parasysh që masat që trajtojnë fushat e lartpërmendura paraqesin prioritetet në kuadër të kësaj thirrjeje. Mund të propozohen lloje tjera të masave përkatëse dhe inovative. Aplikuesit inkurajohen që të angazhohen në fushat për mbrojtjen e mjedisit dhe të kenë një përfshirje gjinore të barabartë në aktivitetet e tyre.

Të drejtë aplikimi

KCSF përmes kësaj thirrjeje për zbatim synon që t'u sigurojë mbështetje financiare organizatave të shoqërisë civile të cilat do të zbatojnë projekte cilësore dhe kuptimplota që kontribuojnë në ndryshime të rëndësishme pozitive në zbatimin e MSA-së.

Për të pasur të drejtë aplikimi, aplikuesit duhet:

- të jenë organizatë joqeveritare e regjistruar në Kosovë;
- të jenë organizatë aktive e shoqërisë civile në Kosovë;
- të kenë përvojë të dëshmuar në zbatimin e suksesshëm të ndërhyrjeve relevante; dhe
- që organizata aplikuese të jetë përgjegjëse për zbatimin dhe menaxhimin e grantit.

Numri i aplikacioneve të paraqitura për projekte

Organizatave me të drejtë aplikimi mund të aplikojnë me më shumë se një projekt-propozim. Megjithatë, aplikuesit nuk mund të jenë përfitues të dy granteve nga kjo thirrje.

Kohëzgjatja e projektit

Kohëzgjatja maksimale për zbatimin e projekteve të propozuara duhet të jetë 18 muaj.

Mbështetja financiare

Shuma maksimale e fondeve për një grant është **20,000 euro**. Aplikuesit inkurajohen të paraqesin buxhete efektive dhe reale.

Përkrahur nga:





Aplikimi

Aplikuesit duhet të aplikojnë me projekt-propozime që janë në përputhje me këtë thirrje dhe të shfrytëzojnë formularin për aplikim standard të kësaj thirrje.

Aplikacionet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Aplikuesit duhet të plotësojnë formularët e aplikacionit në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

Aplikacionet mund të dorëzohen vetëm në formë elektronike në formatet .doc ose .pdf në e-mail-in: kcsfsida@kcsfoundation.org me titullin e temës "**Thirrja e Sida's për MSA - emri i plotë i aplikuesit (akronim)**"

E-maili duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin e plotësuar për grante për projekte (standard për këtë [thirrje](#))
- Shtojcat
 - o Korniza logjike
 - o Forma e buxhetit
 - o Plani i aktiviteteve
- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;

Afati i fundit për të dorëzuar aplikimet për këtë thirrje është **20 nëntor 2017**.

Vlerësimi

Aplikacionet do të vlerësohen nga ana komisionit vlerësues. Gjatë vlerësimit të aplikacioneve, komisioni vlerësues do të marrë në konsideratë relevancën, cilësinë e aplikacionit, buxhetin, kapacitetin e organizatës dhe fushat prioritare të propozuara.

Njoftimi për vendimin

Të gjithë aplikuesit do të njoftohen rreth vendimit të komisionit vlerësues ndërsa lista e përfituesve të granteve do të shpallet në www.kcsfoundation.org.

Kontakti

Çdo pyetje në lidhje me përgatitjen e aplikacioneve ose me detajet e aplikimit të granteve mund të dërgohet në e-mail adresën kcsfsida@kcsfoundation.org.

Sesioni informues

Për të gjitha organizatat e interesuara do të organizohet sesion informues më **10 nëntor 2017**, në ora **11:00**, në **zyret e KCSF-së**, rruga "Fazli Greiçevci" nr. 55, Prishtinë.

Përkrahur nga:

